

Arbër HADRI

ÇESHTJA SHQIPTARE DHE KËSHILLI I TË KATËRVE NË KONFERENCËN E PAQES NË PARIS (JANAR-NËNTOR 1919)

Një ndër ngjarjet më me peshë në historinë shqiptare ndërmjet dy luftërave botërore dhe në përgjithësi, është Konferenca e Paqes në Paris 1919-1920, e cila për nga peshja e vendimeve të saja, si dhe dimensionit i reflektimit të tyre në rrjedhat e mëtejshme evropiane dhe teatrlantike, zë një kaptinë të posaçme jo vetëm në historinë e kombit shqiptar por edhe të popujve të tjerë të Evropës.

Shqyrtimi i çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes ngërthen në vete edhe një varg çështjesh të tjera që krijojnë një tërësi të pandashme. Çështjes së Adriatikut, pjesë e së cilës ishte edhe vetë çështja shqiptare, çështjes greke, kundërhëniet SHBA - Francë, Britani e Madhe, Itali si dhe antagonizmave italo-jugosllave i përkushtohet një vëmendje e posaçme, meqë zberthimi i tyre ndriçon edhe problemin shqiptar në tërësi.

Detyrat e parashtruara për krijimin e paqes së pas Luftës së Parë Botërore ishin po aq komplekse dhe fiktive sa edhe vetë lufta dhe ecuria e procesit të mbarëvajtjes së Konferencës së Paqes. Nomenklatura e çështjeve që duhej zgjidhur si dhe reflektimi i tyre në procese dhe konstelacione afatgjata të politikës ndërkombëtare i dhanë peshë të madhe Konferencës në fjalë, si dhe interesim të theksuar të qeverive të shteteve të ndyshme evropiane dhe teatrlantike. Interesat e Fuqive të Mëdha lidheshin me interesat vetiake strategjike, politike e ekonomike nën prizmin e koncepcioneve politike të kohës.

Në sesionet e para të Konferencës, në janar të vitit 1919, u vendos që të zvogëlohej numri i anëtarëve të sesioneve të Konferencës nga 27 kombe pjesëmarrëse, në Këshillin e të Dhjetëve, që konsistonte nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Vudro Uilsoni, kryeministri francez Xhorxh Klemensoa, kryeministri britanik Dejvid Llojd Xhorxh, kryeministri italian Vitorio Orlando, ministrat e tyre të Jashtëm dhe dy delegatë japonezë; si dhe në Këshillin e të Katërve, i përbërë nga Uilsoni, Llojd Xhorxhi, Klemensoa dhe Orlando. Ky vendim reflektoi pasqyrë të kundërt nga

konceptet fillestare të Konferencës dhe barazinë e të gjitha kombeve, duke i kthyer me këtë rast popujt e vegjël në cilësinë e vëzhguesve.¹

Katërshja e Madhe negocionte me delegacionin gjerman e determinuar që të arrinte një marrëveshje e cila do të shtynte rimëkëmbjen e Gjermanisë si fuqi botërore.² I ballafaquar me këto dëshpërime fillestare, mbi imponimin e tërësishëm të paqes në bazë të Katërmbëdhjetë Pikave, Uilsoni u përqendrua në trasimin e rrugës drejt proceseve që do të çonin në drejtim të zgjidhjeve të problemeve dhe në sigurimin nga kolegët e tij, të përkushtimit ndaj themelimit të Lidhjes së Kombeve.

Kështu, para 7 majit, Katërshja e Madhe përqendrohej në paqen preliminare me Gjermaninë. Mirëpo, pasi që ky dokument u përfundua, Katërshja u ballafaqua me një mori problemesh të tjera të një ujdje më të gjerë evropiane. Problemi kryesor të cilit iu rrekën Uilsoni, Llojd Xhorxhi dhe Klemensoa ishte ai i pretendimeve ekspansioniste të Italisë në rajonin e Adriatikut, si dhe lindja e ambicieve të saja për aneksimin e territoreve në Perandorinë Osmane, me qëllim që të bëhej fuqi e madhe e Lindjes së Afërt. Kacafytjet me italianët mbi çështjen e Adriatikut u intensifikuan dhe të gjitha resurset u përqendruan në gjetjen e kompromisit ndaj determinimit të Italisë që të qëndronte në Fiume (Rijekë).³

Nyja problematike e pretendimeve perandorake të Italisë në Azinë e Vogël, po ashtu, u komplikua edhe nga ambiciet e Francës dhe të Anglisë, si dhe nga pretendimet greke në rajon. Në të njëjtën kohë Këshilli i Lartë duhej të dilte me një zgjidhje të problemit kompleks të shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze dhe krijimit të shteteve të reja në territorin e saj, si dhe me një varg çështjesh të tjera komplekse.⁴

Çështja e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris ishte e lidhur në mënyrë të pandashme me çështjen e Adriatikut. Për këtë arsye trajtimi dhe analizimi i rrjedhës së kësaj çështjeje është në interes të ndriçimit të çështjes shqiptare në përgjithësi.

Mbi çështjen e Adriatikut politika amerikane në fillim ishte konsekuente në qëndrimin se Rijeka duhej t'i mbetej Jugosllavisë, mirëpo më vonë si rrjedhojë e domosdoshmërisë së arritjes së një marrëveshjeje të pranueshme për të gjitha palët, del edhe me propozimin shtesë, në bazë të të cilit ajo duhet të vihet nën mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve për një periudhë


¹ Kendrick A. Clements "The presidency of Woodrow Wilson", University Press of Kansas, 1992, f. 173.

² "The Papers of Woodrow Wilson", ed. Arthur S. Link, vol. 59, Princeton University Press, Princeton, f. VII.

³ "The Papers of Woodrow Wilson", ed. Arthur S. Link, vol. 59, Princeton University Press, Princeton, f. VII.

⁴ Vepra e cituar, f. VIII.

disavjeçare, pas së cilës do të mbahej plebishiti mbi çështjen e ardhmërisë së Rijekës, nëse do të hynte në kuadër të Jugosllavisë apo Italisë. Nëse bëhet pjesë e Italisë, atëherë italianët do të obligohen për ndërtimin e një porti të ri për jugosllavët, në pjesën e poshtme të qytetit. Trumbiqi ishte konsultuar mbi këtë çështje dhe kishte treguar disa shenja lëshimi, mirëpo kryetari Uilson ishte këmbëngulës në pikën se italianët nuk duhet të konsolidohen në formën ekstreme në Bregdetin Adriatik, duke thyer kështu balancën e brishtë politike. Si kundërpërgjigje ndaj barrikadimit të tillë të Uilsonit, italianët thirrëshin në Marrëveshjen e Londrës dhe në obligimin e Francës dhe Anglisë që të mbështesin pikat e kësaj marrëveshjeje.⁵ Mirëpo, në të njëjtën kohë, Marrëveshja e Londrës përmbante në vete edhe një kryesore nebuloze që prolongonte zgjidhjen e çështjes së Adriatikut, çështjen e Rijekës,⁶ e cila sipas kësaj marrëveshjeje i takonte Kroacisë.⁷



Këshilli i të Katërve-Katërshja e Madhe:

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Vudro Uilson, kryeministri francez Xhorxh Klemensoa, kryeministri britanik Dejvid Llojd Xhorxh, kryeministri italian Vittorio Orlando

⁵ From the Diary of Colonel House, May 10, 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", Volume 59, Arthur S. Link. Princeton, New Jersey, Princeton University Press, 1988, f. 34.

⁶ Madje kjo çështje u shkaktoi kokëçarje edhe qeverive të Britanisë së Madhe dhe Francës për shkak të anashkalimit të kësaj çështjejeje para parlamenteve përkatëse, me qëllim të moskomprometimit të qeverisë italiane, ngase opinioni italian nuk ishte informuar si duhet mbi këtë; Ibid. f. 493.

⁷ Mantoux's Notes of a Conversation among Wilson, Clemenceau, and Lloyd George, May 26, 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", Volume 59, Arthur S. Link, Princeton, New Jersey, Princeton University Press, 1988, f. 493.

* * *

Përfundimi i Luftës së Parë Botërore i gjeti trojet shqiptare në një pozitë të papërballueshme, si në aspektin e brendshëm ashtu edhe në konstelacionin ndërkombëtar. Shqipëria ishte nën okupimin e zonave ushtarake të huaja. të trupave pushtuese italiane, franceze, greke e serbe, gjersa Kosova dhe Maqedonia Perëndimore u vunë sërish nën okupimin e dhunshëm serb.

Zgjidhja e çështjes shqiptare pas luftës përcaktohej nga një tërësi elementesh nga të cilat më me peshë ishin faktorët e raportit të forcës, që ishte në dëm të saj, si dhe përcaktimi dhe njohja e parimit të fituesit në luftë kundrejt parimit demografik dhe të vetëvendosjes, në realitet.

Pushtimi i Shqipërisë nga forcat ushtarake të fuqive ndërluftuese nuk ishte thjesht një akt brenda kuadrit të veprimeve operativo-luftarake që diktonin nevojat e luftës. Ai ishte diçka më tepër, një ndërmarrje që fshihte pikësynime politike të caktuara për të ardhmen.⁸

Ekulibri i mëparshëm i forcave në rrafshin ndërkombëtar, nga kishte përfituar disi dhe nga mund të përfitonte çështja shqiptare, ishte prishur tërësisht në dëm të saj. Më 1918 ishin mundur fuqitë e bllokut qendror dhe madje sapo ishte shpërbërë Perandoria Austro-Hungareze, kundërshtarë e ekspansionit serb në Ballkan. Për më tepër, të trija vendet fqinje lakmitare: Italia, Serbia-Mali Zi (Jugosllavia) dhe Greqia, renditeshin ndër fituesit e luftës. Italia, si nënshkruese e Traktatit të Fshehtë të Londrës, të prillit 1915, kërkonte të përfitonte sa më shumë nga klauzolat e tij, duke tentuar t'i veçojë pikat që i përshtateshin asaj dhe duke anashkaluar ato që nuk i hynin në interes, sikurse çështja e Rijekës, duke formuar kështu një kontraverzë ndërkombëtare, në vorbullën e së cilës hyri edhe çështja shqiptare. Dy monarkitë fqinje ballkanike, si fituese të luftës, jo vetëm që donin të ruanin trojet shqiptare të aneksuara më parë, por lakmonin edhe territore të tjera. Ndërkaq Shqipëria, që kërkonte ndreqjen e padrejtësive, ishte një vend që kishte mbetur asnjansës gjatë luftës botërore. Ajo zyrtarisht nuk u bashkua dhe, për disa arsye, nuk mund të bashkohej me asnjërin prej të dy blloqeve ndërluftuese. Mbi të gjitha lufta kishte qenë e huaj për popullin shqiptar përderisa të dy blloqet, më konkretisht Italia me Austro-Hungarinë, ushqenin synime ekspansioniste mbi të. Për të plotësuar këtë pasqyrë të zymtë, nga të katër fuqitë kryesore fituese të luftës: SHBA, Anglia Franca dhe Italia, vetëm kjo e fundit ishte e interesuar të përkrahte kërkesat territoriale shqiptare,⁹ pjesërisht dhe në mënyrë të tërthortë vetëm atëherë

⁸ Paskal Milo, "Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927", Tiranë, 1992, f. 67.

⁹ Muin Çami, "Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës I Botërore", "Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual", Tiranë 1996, f. 138.

nëse shërbenin për interesat e saj ndaj rivalitetit me shtetin në formim e sipër Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, si dhe vetë ekzistenca e shtetit të Shqipërisë ishte vënë në pikëpyetje nga interesat e shteteve fqinje dhe të Fuqive të Mëdha.

Përfundimi i luftës u shtroi organizatave shqiptare, krahas detyrës për ta bërë të njohur çështjen e drejtë shqiptare në opinionin publik botëror, edhe detyrën e ngutshme për të dërguar një delegacion zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes. Lidhur me këtë doli edhe kërkesa për formimin e një qeverie shqiptare që të mbronte interesat kombëtare brenda vendit dhe të përfaqësonte shtetin shqiptar në Konferencën e Paqes. Në këtë konferencë përgatiteshin të dërgonin përfaqësuesit e tyre edhe kolonitë shqiptare jashtë vendit. Nevoja e formimit të një qeverie kombëtare diktohej edhe nga fakti së E. Toptani, të cilin e kishte marrë nën mbrojtje Jugosllavia dhe gëzonte edhe përkrahjen e Francës, përpiqej ta paraqiste "qeverinë" e tij si qeveri legale-shqiptare. Në këto rrethana Roma ishte e interesuar që në Shqipëri të krijohet mbi baza "ligjore" një organ i tillë shtetëror, i cili, duke pasur të drejtën të fliste në emër të popullit shqiptar, t'i shërbente asaj për të mënjeluar çdo përfaqësi tjetër shqiptare që do të paraqitej në Konferencë dhe ta përdorte atë si mbështetje për planet e saj.¹⁰ Detyra e rimëkëmbjes së shtetit të ri shqiptar në këto kushte, u bë tepër e ngutshme.

Në këto kushte u mbledh Kongresi i Durrësit, më 25 dhjetor të vitit 1918.¹¹

Në Kongres morën pjesë mbi 50 përfaqësues të Shqipërisë, por nuk mundën të përfaqësoheshin krahinat e Lumës, Peshkopisë, Korçës e Pogradecit që ndodheshin nën pushtimin serb dhe francez, si dhe krahina e Vlorës, delegatët e së cilës pushtuesit italianë i ndaluan të mermin pjesë. Kongresi nuk i zhvilloi punimet në frymën që kërkonin italianët. Kongresi i Durrësit, duke u mbështetur gjithashtu në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, u shpreh për pavarësinë e Shqipërisë dhe për rishikimin e kufijve në favor të saj duke u mbështetur në kriterin etnik.¹²

Qeveria e Përkohshme që doli nga Kongresi i Durrësit përbëhej prej 14 anëtarësh. Por në kushtet e pushtimit italian dhe për të mënjeluar pengesat që mund t'i sillte Italia dërgimit të një delegacioni qeveritar shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, Kongresi zgjodhi në krye të Qeverisë Turhan Pashë Përmetin dhe anëtarë të saj Myfti Bej Libohovën, Mustafa Krujën etj., që njiheshin si pasues të politikës italiane. Kongresi më 27 dhjetor formoi

¹⁰ "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Pishtinë, 1969, f. 451-454.

¹¹ Aurela Anastasi, "Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)", Tiranë, 1998, f. 39.

¹² "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Pishtinë, 1969, f. 451-453.

Pleqësinë, Senatin. Një pjesë e anëtarëve të Qeverisë, me Turhan Pashën në krye u caktua si delegacion për t'i paraqitur Konferencës së Paqes kërkesat kombëtare shqiptare dhe për t'i mbrojtur ato.¹³

Në Konferencën e Paqes erdhën disa delegacione përfaqësuese të Shqipërisë, të cilat nuk i harmonizuan qëndrimet e tyre dhe formuluan secila në mënyrë vetanake qëndrimet e saja. Në njërën anë qëndronte delegacioni i Qeverisë së Durrësit, në krye me Turhan Pashën, Mehmet Konicën dhe Mihal Turtullin. Ky delegacion në prill të vitit 1919 pësoi ndryshime për shkak të qëndrimeve të kundërta në lidhje me bashkëpunimin me Italinë, duke u zëvendësuar Turhan Pasha me argjipeshkvin Luigj Bumçi, si kryetar i delegacionit. Ky ndërrim nuk ndodhi edhe në kohë aq të qëlluar ngase pikërisht atëherë diskutohej për çështjen e mandatit italian ndaj Shqipërisë si dhe degradohej në nivel më të ulët përfaqësimi në delegacion dhe bëhej e ditur përçarja në kuadrin e delegacionit shqiptar. Delegacionit në këtë kohë iu bashkëngjijtën edhe Luigj Gurakuqi, Lef Nosi si dhe Gjergj Fishta.¹⁴ Gjersa në taborin tjetër qëndronte Esat Pasha, i cili në saje të intrigës dhe të propagandës politike që ushtronte, trajtohej nga Franca, Italia, Greqia dhe Serbia, për arsye tashmë të ditura, në mënyrë të njëjtë sikurse delegacioni qeveritar në Konferencë, dhe si i tillë gëzonte një vëmendje të veçantë në raportet e ndërsjella me ato. Po ashtu, edhe organizatat shqiptare: Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës",¹⁵ e emigrantëve shqiptarë në Rumani, Turqi dhe SHBA dërguan në Paris përfaqësuesit e tyre, të cilët vepruan në përputhje të plotë me delegacionin e Qeverisë së Përkohshme, kështu që Esat Pasha mbeti plotësisht i izoluar.¹⁶

Për arsye të publicitetit dhe popullaritetit të papritur të Konferencës, propaganda dhe ndikimi në mendimin publik luajtën një rol me rëndësi. Delegacioni grek erdhi në Konferencë me një sistem të përpunuar të propagandës dhe përfaqësohej në mënyrë unike nga vetë presidenti Venizellos dhe bashkëpunëtori i tij i ngushtë, Politis, dhe si e tillë ishte në përparësi të dukshme ndaj palës shqiptare. Ajo mbështetej edhe në Ligën

¹³ Ibid.

¹⁴ AQSH, Fondi 251, dosja 10, viti 1919, f. 235-240; Gjergj Fishta gjatë mungesës fillestare të përfaqësuesve të Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" ishte autorizuar t'i mbronte interesat e saj; Lush Culaj, Roli i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" për çështjen shqiptare në Paqen e Versajës, Gjurmime albanologjike, 26, 1996, f. 152.

¹⁵ Përfaqësuesit e së cilës në krye me Hasan Prishtinën, për shkak të disa obstrukcioneve gjatë udhëtimit, me vonësë-në muajin tetor, arritën në Konferencën e Paqes. Lush Culaj "Roli i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" për çështjen shqiptare në paqen e Versajës", Gjurmime albanologjike, 26, 1996, f. 150-153.

¹⁶ Haris Silajxhiq, " Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit", 1991, Tiranë më 1999, faqe 64.

anglo-helenike, e themeluar në vitin 1913, Shoqërinë amerikano-helene, e themeluar më 1917, si dhe Unionin Pan-epirot po në Amerikë, që përfaqësonin shtyllën kurizore të propagandës greke. Edhe delegacionin shqiptar e mbështesnin dy organizata të tilla. Federata panshqiptare "Vatra", e themeluar në vitin 1909, dhe Shoqata anglo-shqiptare, e themeluar në Londër në vitin 1918, u përpoqën të japin me propagandë ndihmesën e tyre në favor të çështjes shqiptare. Emigrantët shqiptarë në përgjithësi, dhe në veçanti ata të Amerikës, mbështetën shumë shpresa tek Konferenca e Paqes dhe sidomos tek presidenti Uilson.¹⁷

Vatra dhe udhëheqësit e emigracionit shqiptar në Amerikë përparuan gradualisht deri në pozicionin në të cilin presionet e tyre mund të ndikonin në zyrtarët e Uashingtonit, që merreshin me çështjen e Adriatikut. Falë punës sistematike, këmbëngulëse dhe të palodhur të Vatrës në përgjithësi dhe intelektualëve shqiptarë në veçanti, sikurse Peci, Noli, Konica, Dako, Petro Nini Luarasi etj., Shqipëria kishte reprezentim në Amerikë dhe zëri i tyre depërtohte në qendrat e vendosjes amerikane. Fushata e Vatrës për mbledhjen e fondeve mblodhi përafërsisht 150.000\$, shumë e madhe për vlerën e atëhershme të dollarit, me qëllim të financimit të delegacionit të saj në Konferencë, të kryesuar nga Mehmet Konica. Dhe, pikërisht nga filltet e tilla, një përfaqësues shqiptar, i personifikuar në Fan Nolin, ishte prezent, së bashku me përfaqësuesit e 32 grupeve të tjera etnike, në fjalimin e Mount Vernonit më 4 korrik të vitit 1918, kur presidenti Uilson e shpali programin e tij të paqes. Në jahtën presidenciale, në rrugën e kthimit për në Uashington, Uilsoni e siguroi Nolin për simpatinë ndaj çështjes shqiptare dhe shfaqti vendosmërinë në ndihmë të rivendosjes së pavarësisë së vendit në Konferencën e Paqes. Në këtë udhëtim, sipas fjalëve të Nolit, Uilsoni i është drejtuar atij me këto fjalë: "Do të kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes, mirëpo këtë zë do ta përdor për të drejtat e Shqipërisë". Në të njëjtën ditë ish-kryetari amerikan Teodor Ruzvelt, i cili po ashtu u kontaktua nga liderët shqiptarë, në fjalimin e tij në Nju Xhersi, përfshiu Shqipërinë në listën e vendeve, pavarësia e të cilave do të duhej të rivendosej dhe të garantohej nga aleatët.¹⁸

Mirëpo, gjatë shqyrtimeve në Konferencën e Paqes ekzistonin disa faktorë të rëndësishëm që kushtëzuan situatën jo të favorshme të delegacionit shqiptar. Qeveria e Përkohshme nuk ishte njohur nga fuqitë evropiane, kështu që Shqipëria nuk mund të përfaqësohej zyrtarisht në

¹⁷ Po aty, f. 65.

¹⁸ "Seminari ndërkombëtar i Federatës Panshqiptare "Vatra", Nju Jork, 28-30 Nëntor 1969, f. 91-92.

Konferencë. Pamundësia e kontaktit direkt me pjesëmarrësit në Konferencë nuk mund të kompensohej me asgjë.¹⁹

Mund të themi se Amerika zyrtare në këtë periudhë ishte indiferente ndaj rastit të Shqipërisë. Uilsoni, në një letër dërguar Sekretarit të Departamentit të Shtetit, Robert Lansing, i kërkon që të merret me Shqipërinë, domethënë me kërkesat e shqiptarëve dhe "me raste të tilla të ngjashme". Disa ekspertë amerikanë ishin të pasigurt në "drejtësinë e pavarësisë së Shqipërisë dhe Shqipërinë e rreshtonin në klasën e shteteve të reja të mundshme".²⁰

Delegacioni i Qeverisë së Durrësit në Paris i paraqiti Konferencës së Paqes më 15 shkurt memorandumit e parë, kurse më 24 shkurt, kur u dëgjua nga "Këshilli i të Dhjetëve", që përbëhej nga kryetarët e qeverisë dhe ministrat e Punëve të Jashtme të pesë fuqive organizuese të Konferencës, paraqiti një memorandum të dytë. Në këto memorandume pavarësia e Shqipërisë konsiderohej e siguar me vendimin e 1913-ës dhe kërkohej korigjimi i gabimeve territoriale që ishin bërë me vendimet e Kongresit të Berlinit më 1878 dhe të Konferencës së Londrës më 1913 në dëm të Shqipërisë, duke lënë jashtë kufijve të saj trevat e banuara prej shqiptarëve, Kosovën (në kuadër të të cilit term përfshiheshin edhe shqiptarët e Maqedonisë Perëndimore dhe të Malit të Zi), si dhe Çamërinë.²¹

Kërkesat shqiptare i kaluan për shqyrtim Komisionit për çështjet greke, që ishte formuar në fillim të shkurtit dhe ku mermin pjesë përfaqësuesit e SHBA-ve, Anglisë, Francës dhe Italisë. Në fillim të marsit ky komision i paraqiti këshillit raportin e tij. Në lidhje me kufirin shqiptaro-grek pikëpamja e katër fuqive nuk ishte e njëjtë. Ndërsa Italia ishte për ruajtjen e kufijve të 1913-ës në Jug, përfaqësuesit francezë dhe anglezë, duke synuar që pozitat e rëndësishme strategjike: bregdeti shqiptar, që kontrollonte kanalin e Korfuzit dhe ruga Sarandë-Janinë-Korçë-Follorinë, të mos mbeteshin në kufijtë e një Shqipërie nën varësinë e Italisë, propozonin që Korça dhe Gjirokastra t'i kalonin Greqisë. Në këtë qëndrim të tyre shprehej edhe synimi i Qeverisë së Parisit për të ngushtuar zgjerimin e Italisë në Ballkan dhe qëllimi i qeverisë angleze për ta lidhur Greqinë pas vete, në mënyrë që ta bënte një vegël në mbrojtjen e interesave të Anglisë në Ballkan dhe veçanërisht në Lindjen e Afërt. Përfaqësuesit e SHBA-ve, të cilët mbajtjen e Vlorës nga ana e Italisë e quanin të mjaftueshme për "sigurimin" e appetiteve italiane në Adriatikun

¹⁹ Haris Silajxhiq, "Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit", 1991, Tiranë më 1999, f. 66.

²⁰ "Relacionet e Vudro Uilsonit", Kllouz Llansingut, Paris 13.02.1919; cituar nga Haris Silajxhiq, "Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit", 1991, Tiranë më 1999, f. 66.

²¹ "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Pishtinë, 1969, f. 454-456.

Jugor, dolën me propozimin që krahina e Gjirokastrës deri në bregdet, krahinë e cila lidhej me kanalin e Korfuzit, t'i jepej Greqisë, ndërsa Korça të mbetej në kufijtë e Shqipërisë.²²

Të gjitha këto rrethana negative çuan në atë që dëgjimi i delegacionit shqiptar, më 24 shkurt 1919, në Këshillin e të Dhjetëve, të ishte thjesht formal dhe të mbetej pa asnjë jehonë. Për pasojë, pas dëgjimit të këtij delegacioni Këshilli i të Dhjetëve nuk ngriti asnjë komision të posaçëm për shqyrtimin e kërkesave territoriale shqiptare, sikurse kishte vepruar për rastet analoge të vendeve të tjera, si për Greqinë në fillim të shkurtit.²³

Për shkak të këtyre kontradiktave çështja e kufirit shqiptaro-grek mbeti e hapur, ndërsa i gjithë problemi shqiptar ishte lidhur me çështjen e Adriatikut. Mospërfillja e kërkesave shqiptare dhe përkrahja që gjenin në konferencë pretendimet e fqinjëve i shqetësuan delegatët shqiptarë në Paris, ku filluan të vinin edhe përfaqësues nga kolonitë shqiptare të Turqisë, SHBA e Rumanisë. Në këto kushte Turhan Pasha i dërgoi Konferencës më 7 mars një notë që synonte të ritheksonte drejtësinë e kërkesave të tij, faktin se këto bazoheshin në parimin e kombësisë, me anën e së cilës u kërkonte që SHBA të administronin për një ose dy vjet trojet shqiptare të Kosovës, që kishin mbetur jashtë kufijve të 1913-ës ku duhej të organizohej një plebishit për caktimin e fatit të tyre dhe, në qoftë se kjo pranohej, SHBA ta shtrinin pushtimin e përkohshëm, me qëllim plebishiti, edhe në dy krahinat e Shqipërisë së Jugut që pretendonte Greqia si dhe në Çameri. Po ashtu, kërkohesh edhe përcaktimi i SHBA si mandatore e Shqipërisë.²⁴

Komisioni, sipas mendimit të delegacionit, la përshtypjen e njëanshmërisë, ngase kërkesave greke ua kushtoi gjithë vëmendjen, kurse kërkesave të Shqipërisë, nëpërmjet të cilave kërkoheshin vetëm ato territore të banuara nga popullsi shqiptare, nuk iu kushtua kurrfarë vëmendjeje.²⁵

Koncepti amerikan mbi mandatin ndaj Shqipërisë ishte meritë e Çarls Telford Erikson, i cili punoi me këmbëngulje që Uilsoni dhe të tjerët ta pranonin mandatin. Eriksoni, në bashkëpunim me Mehmet Konicën, dha një ndihmesë të veçantë, shtypi memorandumin, të cilin ia dërgoi Konferencës së Paqes. Memorandumi mban titullin "Gjashtë arsye për të cilat Amerika duhet të bëhet mandatore ndaj Shqipërisë".²⁶ Arsyeja parë, sipas Eriksonit,

²² Po aty.

²³ Muin Çami, "Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës I Botërore", "Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual", Tiranë 1996, f. 139.

²⁴ "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Pishinë, 1969, f. 454-456.

²⁵ Haris Silajxhiq, "Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit", 1991, Tiranë më 1999, f. 93.

²⁶ C.T. Erikson "Six Reasons why Amerika should become mandatory for Albania", Paris, Maj 1919.

është fakti që Amerika hyri në luftë për synime morale. Parimi i mbrojtjes së popujve të vegjël është një nga parimet bazë që ka shpallur presidenti Uilson. Megjithatë, ky parim nuk do të zbatohet në rastin e Shqipërisë, veçse kur ta zbatojë Amerika. Arsyeja tjetër është se Amerika, duke pranuar mandatin, do të kryente obligimin e Konferencës së Paqes për mbrojtjen e të drejtave të kombeve dhe për vendosjen e kufijve mbi baza etnike. Amerika e ka për detyrë ta pranojë thirrjen e shqiptarëve, të cilët kërkojnë ndihmë.²⁷

Nën shtytjen e përfaqësuesve të kolonive dhe të disa anëtarëve të delegacionit të Qeverisë së Durrësit, të cilët burimin e fatkeqësive të reja që binin mbi Shqipërinë e shikonin, në kundërshtim me Turhan Pashën, në politikën e Italisë, më 17 mars iu dërgua Konferencës një notë e re, me anën e së cilës kundërshtohej zbatimi i Traktatit të fshehtë të Londrës. Por këto nota, që kishin për qëllim të tregonin se qarqet patriotike shqiptare ndiqnin një politikë të pavarur për mbrojtjen e interesave kombëtare, nuk dhanë ndonjë rezultat.²⁸

Po ashtu, gati një muaj më vonë delegacioni i paraqiti Konferencës një varg statistikash të nxjerra nga burimet e ndryshme (turke, austriake e bullgare) nëpërmjet të cilave argumentohej se trojet në verilindje që delegacioni shqiptar kishte kërkuar t'i bashkoheshin shtetit shqiptar, banoheshin në shumicë nga shqiptarë, në masën rreth 80%. Megjithatë, edhe këto ndërhyrje të reja të delegacionit shqiptar mbetën përsëri pa lënë gjurmë.²⁹

* * *

Politika ballkanike e shtetit të ri jugosllav, të krijuar në fund të Luftës së Parë Botërore, mbeti po ajo e Serbisë dhe Malit të Zi të paraluftës, meqë koniunkturaturat udhëheqëse politike nuk kishin ndryshuar. Nuk kishte ndryshuar as politika gjenocidale ndaj popullit shqiptar në Kosovë, që udhëhiqej nëpërmjet shkombëtarizimit të trojeve shqiptare që gjendeshin nën juridiksionin jugosllav, si dhe në veprimet e pandërprera brenda në Shqipëri dhe në arenën ndërkombëtare për dobësimin dhe komprometimin e saj si shtet, veprime këto që në instancën e fundit duhej të rezultonin me realizimin e synimeve hegjemoniste ndaj saj.³⁰

²⁷ Haris Silajxhiq, "Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit", 1991, Tiranë më 1999, f. 91.

²⁸ "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Pishtinë, 1969, f. 454-456.

²⁹ Muin Çami, "Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës I Botërore", "Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual", Tiranë 1996, f. 140.

³⁰ Emine Arifi-Bakalli, "Marrëdhënjet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939", Prishtinë, 1997, f. 11-12.

Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", i cili në vitet 1919 luajti një rol shumë të rëndësishëm në hapësirën shqiptare, veçoi pareshtur në drejtim të tërheqjes së vëmendjes së të drejtave të popullit shqiptar në tokat e copëtuara në vitin 1913, për vetëvendosje që mbështetej edhe me organizimin e qëndresës së armatosur në rajonet e aneksuara padrejhtësisht dhe bashkimin e tyre me shtetin kombëtar. Më 20 dhjetor të vitit 1918 Komiteti njoftonte Fuqitë e Mëdha për mizoritë e ushtrisë serbe mbi shqiptarët në Kosovë. Më 28 dhjetor 1919 Komiteti iu drejtua presidentit të SHBA, Vudro Uilson, duke shpresuar se ndikimi amerikan do të ndihmonte në zgjidhjen e çështjes shqiptare. Letra u shoqërua me shënime të hollësishme për mizoritë e ushtrisë serbe, e cila punonte për të vënë në zbatim urdhrat e Beogradit për pastrimin etnik të rajoneve. Në fillim të vitit 1919 në viset shqiptare të pushtuara dhe në qarqet politike u përkrah mendimi për organizimin e një kryengritjeje të përgjithshme të armatosur, e cila do të kishte për qëllim ta tërhiqte vëmendjen e opinionit ndërkombëtar mbi të drejtat dhe aspiratat e popullit shqiptar në Kosovë. Kryengritja e 29 prillit të vitit 1919 ishte në funksion të këtij qëllimi, kryengritjeje e cila zgjati rreth 6 javë dhe përfshiu rrethin e Rahovecit, Llaushën dhe Drenicën.³¹

Duke vënë në pah se zgjidhja e çështjes shqiptare në Versajë duhej të ballafaqohej me „diplomacinë kokëfortë të Francës dhe me diplomacinë e stërholluar angleze“, përfaqësuesit e Komitetit të Kosovës mendonin se në radhë të parë shkaqet ekonomike diktonin që këto shtete të mbronin qëndrime të tilla. Në qoftë se Klemensoa është armik i Shqipërisë-theksonte kryetari i Komitetit, arsyeja qëndronte në atë se "nga një Serbi e vogël dëshiron të krijojë një Jugosllavi të madhe", për kthimin nga ana e saj të borxhit prej 20 miliardë frangash³² dhe të interesave gjeostrategjike e ekonomike të tjera. Në cilësinë e kryetarit të Komitetit të Kosovës, Kadri Prishtina disa herë iu drejtua presidentit Uilson për informimin në lidhje me situatën në territoret e pushtuara shqiptare. Delegacioni i shqiptarëve në Konferencën e Paqes më 07.03. 1919 kërkoi zyrtarisht që SHBA të merren me rregullimin e problemeve të imponuara nga faktorë të ndryshëm në Shqipëri.³³

Mirëpo, në kushtet kur Konferenca e Paqes i mbylli dyert për rishikimin e problemit të Kosovës me rrugë diplomatike, në disa qarqe shqiptare sa vinte e dominonte mendimi i ndërmarrjes së veprimeve të tjera me karakter

³¹ Limon Rushiti, "Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" dhe lëvizja kaçake në Kosovë, si forma të luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar (1918-1925)", "Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual", Tiranë 1996, f. 148- 151.

³² Lush Culaj, "Roli i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" për çështjen shqiptare në paqen e Versajës", Gjurmime albanologjike, 26, 1996, f. 154-155.

³³ Ibid.

ushtarak. Nën këtë prizëm në vjeshtë të vitit 1919 ishte në qarkullim edhe organizimi i një kryengritjeje të përgjithshme çlirimtare në Kosovë, që do të tërhiqte vëmendjen dhe interesimin e faktorit ndërkombëtar rreth kësaj çështjeje. Ithtar i këtij mendimi u bë veçanërisht Hasan Prishtina, i cili organizimin e kësaj kryengritjeje nuk e quante të vështirë. Në këtë rast ai kishte parasysh kundërshtimin që ndeshte shteti i ri serbo-kroato-slloven në konsolidimin e tij për shkak të pakënaqësisë që shfaqte ndaj dhunës serbe, jo vetëm populli shqiptar në Kosovë e gjetiu, por edhe popujt e tjerë.³⁴ Me pikëpamjen e tij duket se në fillim u bashkua edhe kryetari i Komitetit "Mbrotja Kombëtare e Kosovës", Hoxhë Kadriu. Duket gjithashtu se mendimin e Hasan Prishtinës e nxitën edhe hapi ushtarak i aktit të kryer të D'Anuncios në shtator 1919 në Rijekë, si dhe lëvizja antiserbe e kroatëve. Mirëpo, mendimi i Hasan Prishtinës për kryengritjen e përgjithshme nuk u mbështet nga anëtarët e tjerë të Komitetit të Kosovës, kur ata u vunë në dijeni.³⁵ Një ide e tillë e një kryengritjeje gjithëkombëtare në Kosovë do të ishte më se e qëlluar në kontekstin kohor, duke përqendruar vëmendjen e pjesëmarrësve të Konferencës në problemin e Kosovës, i cili ishte mospërfillur tërësisht në punimet e saj dhe do të tregonte gatishmërinë e popullit shqiptar për sakrificë ndaj çdo okupimi të dhunshëm dhe mbrojtjen e të drejtës së vetëvendosjes me çdo kusht, edhe me lëvizje të armatosur.

Në këtë kohë u vu në lëvizje edhe E. Toptani i cili, duke dashur të kthehej në Shqipëri dhe të vihej në krye të shtetit shqiptar, e paraqiti veten si „aleat dhe kryetar të qeverisë shqiptare“. Në memorandumun e vet të 16 prillit ai kërkonte respektimin e vendimeve të Konferencës së Londrës dhe caktimin e një komisioni të ri ndërkombëtar të kontrollit, ku vendin e Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë ta zinin SHBA.³⁶

Delegacioni i Qeverisë së Durrësit në Paris, duke parë se kërkesat e paraqitura prej tij nuk po përfilleshin e se të tri fuqitë kryesore ishin dakord të kënaqnin pretendimet italiane në Shqipëri, u përpoq të arrinte me italianët një marrëveshje të pranueshme për të dyja palët. Në propozimet e veta të 3 dhe 28 majit delegacioni, përveç "asistencës" italiane që nuk duhej të prekte

³⁴ AQSH, Fondi Komiteti i Kosovës, dosja 8. Letër e H. Prishtinës e datës 9 tetor 1919, drejtuar Qerim Beut (dok. 708.420); cituar në Muin Çami "Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës I Botërore", "Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual", Tiranë 1996, f. 140.

³⁵ Muin Çami, "Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës I Botërore", "Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual", Tiranë 1996, f. 140; AQSH, Fondi Komiteti i Kosovës, dosja 27, fl. 84-87. Letër e Hoxhë Kadriut e datës 29 tetor 1919; Po aty, dos. 51, fl. 5-6, 25-29; Po aty, dos. 5 (dok. 70006.589). Letër e H. Kadriut drejtuar Hoxhë Xhemajlit më 25 dhjetor 1919.

³⁶ "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Pishinë, 1969, f. 457-459.

sovrانيتin e Shqipërisë, pranonte që në krye të shtetit shqiptar të vihej një princ nga dera italiane e Savojës, dhe, në qoftë se Italia garantonte tërësinë tokësore të Shqipërisë, i njihte Romës interesat e saj "strategjike dhe detare" në Vlorë. Në fund të qershorit kryetari i delegacionit, kryeministri Turhan Pasha, u zëvendësua me Luigj Bumçin.³⁷

* * *

Në kapërcyell të muajit maj,³⁸ në tryezën e Katërshes së Madhe, çështja e bregdetit të Dalmacisë dhe Rijekës ishte prapë në rend të ditës. Kjo mbledhje i solli në sipërfaqe pikëpamjet e kundërta të presidentit Uilson dhe kryeministrit të Italisë, Orlandos. Orlando theksonte se edhe pse ai ishte i gatshëm të pranonte formimin e qytetit të lirë të Rijekës, nuk ishte i gatshëm në lidhje me këtë të lëshonte asgjë më tepër pe. Po ashtu, ai vuri në dukje se po qe se pikëpamja e tij nuk do të pranohej, ai do të insistonte në implementimin e Marrëveshjes së Londrës. Kryetari Uilson në fjalimin e tij e karakterizoi Marrëveshjen e Londrës si një ujdj famëkeq dhe përsëri spikati se nën asnjë rrethanë Shtetet e Bashkuara nuk do të jenë pjesëmarrëse në përcaktimin e kufijve të Jugosllavisë, nën limitacionin e parashtuar nga kjo marrëveshje diskutabile.³⁹ Uilsoni më pas nënvizoi se Marrëveshja e Londrës është e epokës së kaluar dhe se ai nën asnjë kusht nuk do ta përvetësonte atë. Për më shumë, ai spikati se askush nuk ka të drejtë të thirret në marrëveshjen e sipërpërmendur, në mënyrë që t'i akordohen territoret e Dalmacisë apo territoret e tjera, Italisë, pa respektuar me këtë rast dëshirat dhe vendimet e banorëve të këtyre tokave.⁴⁰ Bindjet e kryetarit të SHBA ishin aq të thella, sa që Klemensoa ia parashtroi brengosjen e tij të thellë Orlandos, duke cekur se pala italiane do të duhej t'i modifikonte aspiratat e saja në përputhshmëri me pikëpamjet e Uilsonit. Klemensoa ia tërhoqi vërejtjen Orlandos se mospërfillja e Amerikës nën këto kushte me siguri që për palën italiane do të tregohej katastrofike më vonë. Llojd Xhorxhi kishte simpati ndaj qëndrimit italian, megjithatë sesioni u mbyll pa ndonjë marrëveshje definitive.⁴¹

³⁷ Po aty.

³⁸ Takimi i Katërshes së Madhe më 26 Maj 1919.

³⁹ From the Diary of Dr. Grayson, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 59, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 479.

⁴⁰ From the Diary of Ray Stannard Baker, 26 May 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", Volume 59, Arthur S. Link, Princeton, New Jersey, Princeton University Press, 1988, f. 480.

⁴¹ From the Diary of Dr. Grayson, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 59, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 479.

Si pikë kompromisi në këto diskutime u tentua të futej edhe çështja e Shqipërisë. Edhe pse Uilsoni ishte i gatshëm të diskutonte çështjen e Shqipërisë, ky ishte një propozim i ri dhe ai nuk ishte në gjendje ta pranojë atë pa hezitim. Ai u pajtua se një mandat për Shqipërinë ishte i domosdoshëm, mirëpo, insistoi që kjo çështje të trajtohet në kuadrin e çështjeve të mandateve. Pikëpamjet e Treshes së Madhe mbi çështjen e mandatit konsistonin në faktin se Franca, Britania e Madhe apo SHBA nuk kishin interes të veçantë për mandatin mbi Shqipërinë, kështu që edhe në pikëqëndrimet e Uilsonit Italia gjithsesi do ta ketë përparësinë në lidhje me çështjen e mandatit. Presidenti Uilson nuk e hodhi poshtë këtë koncept, mirëpo e rezervoi këtë problem për shqyrtime shtesë.⁴²

Çështja e Shqipërisë ishte e lidhur ngushtë me çështjen e Dalmacisë dhe të Rijekës dhe si e tillë ishte në të gjitha projektpropozimet e ndërlydhura me çështjen e Adriatikut. Kështu, në projektpropozimin e 28 majit të vitit 1919 Rijeka ishte paraparë të formohej si shtet i pavarur nën sovranitetin dhe mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve, për një periudhë 15- vjeçare pas së cilës do të mbahej referendumi mbi çështjen e statusit të saj. Territori administrativ i qytetit të Rijekës do të kishte autonomi - corpus separatum, si dhe do të ishte port i hapur; Dalmacia do të ishte nën sovranitetin jugosllav, përpos Zarës, Shibenikut, si dhe ishujve të Dalmacisë dhe Kroacisë të cilët do të ishin objekt i bisedimeve të mëtejshme. Italisë do t'i akordohej mandati ndaj Shqipërisë. Kufiri verior i Shqipërisë nuk do të ndryshohej, gjersa kufiri jugor i saj do të përcaktohej nga Konferenca. Përgjatë Shqipërisë do të ndërtohej hekurudha me një kapital të përzier: 40% kapital italian, 40% jugosllav dhe 20% nga shtetet e tjera.⁴³

Në këtë sesion të Katërshes së Madhe Llojd Xhorxhi mbronte pikëpamjen se çështja e Shqipërisë duhet të studiohet pa paragjykime dhe se kishte shumë për t'u thënë mbi çështjen e mandatit, i cili mund t'i besohej Italisë. Po ashtu, duke trajtuar ekspansionin italian theksonte se është e vështirë për Italinë dhe do të kishte konsekuenca nëse i bashkëngjiten territorit të saj, popullatë e cila nuk dëshiron t'i nënshtrohet.⁴⁴

⁴² Hankey's Notes of a Meeting of the Council of Four, May 28, 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 59, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 556.

⁴³ Appendix I to CF-37A, Bases of arrangement, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 59, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 559.

⁴⁴ Mantoux's Notes of a Meeting of the Council of Four, May 28 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 59, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 565.

Muaji qershor në Konferencën e Paqes në Paris shënon përpjekjet e pareshtura të Katërshes së Madhe në bindjen e palës gjermane për pranimin e kushteve të një marrëveshjeje paqe.

Në agjendën e Këshillit të Lartë ishin trajtimi i çështjeve të ratifikimit të territoreve të Gjermanisë, pranimit të Gjermanisë në Lidhjen e Kombeve, obligimet e reparacionit të Gjermanisë - që u përcaktua të ishin rreth 30 bilionë dollarë, shumë e cila, sipas kapacitetit ekonomik të Gjermanisë, do të përcaktohej definitivisht nga Komisioni i Reparacionit në vitin 1921.⁴⁵

Katërshja e Madhe hodhi një hap drejt një përparimi substancial në marrëveshjen me Austrinë, duke u futur kështu në spiralen e kontraverzës italo-jugosllave, në lidhje me ndarjen e gjiut të Klagenfurtit mes Austrisë dhe Jugosllavisë. Uilsoni në ndërkohë shërohet nga sëmundja virale dhe nga me siguri një infarkt i intensitetit të ulët, që e kaploi në prill.⁴⁶

Çështja e Adriatikut hyri në një periudhë të stagnimit meqë asnjë përparim nuk u arrit me palën jugosllave. Uilsoni mendonte se nëse kështu vazhdon puna, si italianët ashtu edhe jugosllavët nuk do të jenë të kënaqur me marrëveshjen. Ai mendonte se për italianët do të ishte më mirë nëse do të merrnin disa ishuj strategjikë dhe ta lenin me këtë.⁴⁷ Çështja e kontrollimit të apetitit italian në Adriatik dhe Azi të Vogël ishte një ndër problemet më akute që e preokuponte Uilsonin. Gurthemel për delegacionin amerikan ishin konceptet e nënvizuara nga Uilsoni në programin e politikës së jashtme, vija politike e përcaktuar më parë nga ai,⁴⁸ si dhe prononcimet e mëparshme nga të cilat nuk kishte luhatje. Kjo shprehet më së miri në vendosshmërinë e presidentit Uilson ndaj çështjes së Adriatikut, në lidhje me të cilën nuk kishte devijim të politikës amerikane dhe mbronte qëndrimin se çdo projekt marrëveshjeje që ka të bëjë me problemin e Adriatikut e që nuk është e pranueshme për të dyja palët, do të konsiderohej si e dështuar. Kjo marrëveshjeje do të duhej të respektohte vullnetin e popullatës shumicë të rajonit, dëshira e së cilës nuk ishte të futet nën flamurin italian.⁴⁹

Problemi i Marrëveshjes së Londrës ishte njëra ndër çështjet më akute që trajtoheshin në Konferencë, problem i cili tërhiqte në vullnetin e saj edhe

⁴⁵ "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 60, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey; f. VIII.

⁴⁶ Ibid.

⁴⁷ From the Diary of Colonel House, June 2 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 60, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 40.

⁴⁸ From the Diary of Dr. Grayson, June 4 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 60, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 116.

⁴⁹ To Thomas Nelson Page, 5 June 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 60, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 176.

një mori çështjesh të tjera të rëndësishme. Ishin pikërisht çështja e Adriatikut dhe ajo shqiptare që ishin të varura nga pranimi apo hudhja e saj.

Politika amerikane hidhte poshtë decidivisht çdo lloj marrëveshjeje të fshehtë dhe të bazuar në kurriz të vendeve të tjera. Kjo ishte në kundërshtim me të Katërbëdhjetë Pikat, nuk ishte në vazhden e vijës politike të përcaktuar nga Uilsoni dhe thente skajshmërisht parimet e vetëvendosjes së popujve. Delegacioni amerikan tentonte në çdo mënyrë ta minonte këtë marrëveshje të fshehtë. Negociatat rreth statusit të Rijekës hodhën në pah divergjencat rreth implementimit të saj. Kështu, Uilsoni theksonte se që në momentin kur Orlando refuzoi që Rijeka t'u akordohej jugosllavëve, ata ishin të liruar nga Marrëveshja e Londrës. Po ashtu, nëse pikat strategjike vlenin për italianët atëherë këto duhej në mënyrë reciproke të vlenin edhe për jugosllavët.⁵⁰ Qëndrimi i Uilsonit ndaj Bregdetit Adriatik ishte se ai me çdo kusht e kundërshtonte instalimin e sovranitetit italian në këtë bregdet, meqë kështu ndryshohej balanca e brishtë politike e Ballkanit dhe prekeshin interesat e Fuqive të Mëdha.⁵¹

Në fund të qershorit vëmendja kryesore në punimet e Konferencës përqendrohej rreth dhe në lidhje me qëndrimet e delegacionit të ri italian, pas ndërrimeve në qeveri dhe përshtatja e politikës përkatëse të Fuqive të Mëdha kundrejt qëndrimeve të reja italiane. Delegacioni italian tashti kryesohet nga Titoni, me përbërje fillestare nga: senator Scialoja, Markoni, Imperiali, Feraris etj. Përparësi e këtij delegacioni ishin gjetja sa më e shpejtë e zgjidhjes së çështjes së Adriatikut, përfitime sa më të mëdha në Azinë e Vogël, duke përfshirë këtu edhe pjesën më të madhe të Anatólisë, si dhe një lloj mandati për Armeninë, Gjeorgjinë dhe Azerbajxhanin.⁵²

Katërshtja e Madhe vazhdon të kacafytet me një mori çështjesh që kërkonin një adresim dhe zgjidhje adekuate, sikurse përfundimi i marrëveshjeve me Poloninë, Rumaninë; në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e minoriteteve në këto vende; e ardhmja e provincave baltike, rrëshqitja e Rusisë; pikat kundërtënëse italo-jugosllave rreth Karinthisë; luftërat e pafund ndërmjet polakëve dhe ukrainasve në Galicinë Lindore; si

⁵⁰ TMS (SDR, RG 256, 180.03401/491/2, DNA), "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 60, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 211.

⁵¹ Mantoux's Notes of a Meeting of the Council of Four, June 6 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 60, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 217.

⁵² Peter Augustus Jay (Konsull dhe atarshe për politikë pranë Ambasadës amerikane në Romë) to the American Mission, June 23 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 61, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 109.

dhe fati i Turqisë dhe e ardhmja e rregullimit të provincave të ish-Perandorisë Otomane. Këto probleme vazhduan të kërkojnë zgjidhje edhe pasi që Uilsoni u largua nga Parisi. Përveç kësaj, Uilsoni, Llojd Xhorxhi dhe Klemensoa u orvatën pa shpresë që edhe një herë të tentojnë ta bindin qeverinë italiane për të hapur rrugë drejt një zgjidhjeje të kënaqme dhe për të hequr dorë nga pretendimet pa bazë në Adriatik.⁵³

Qëndrimi i Uilsonit, e më këtë edhe qëndrimi i politikës amerikane ndaj çështjes së Adriatikut, shprehët më së miri në memorandumin⁵⁴ e 24 qershorit, të dërguar sekretarit të shtetit Robert Lansingut, në të cilin shtrohet bazamenti i politikës amerikane ndaj kësaj çështjeje. Në bazë të këtyre parimeve, misioni amerikan do të duhej të pozicionohej përballë delegacionit të ri italian në Konferencën e Paqes.

Pikat kryesore të cilat do të duhej të ishin udhërrëfyese të politikës amerikane ndaj problemit të Adriatikut ishin:

I. Pozicioni amerikan do të qëndrojë i njëjtë sikurse gjatë gjithë diskutimeve të mëparshme me zotëri Orlandon dhe baronin Sonino, kështu që do të ishte i kotë dhe joracional çdo rishqyrtim i fushave të diskutimit të mëparshëm.

II. Nuk ka më ndonjë interes në insistimin në Marrëveshjen e Londrës, meqë Shtetet e Bashkuara janë tashti garant esencial i të gjitha marrëveshjeve të ndërmarra, dhe asnjë aksion i ndërmarrë nga Britania e Madhe apo Franca nuk do të mund të jetë efektiv pa të.

III. Rijeka në asnjë mënyrë nuk mund t'i takojë Italisë. Duhet të formohet vetëm si një shtet i pavarur. Në kuadër të këtij shteti qyteti i Rijekës mund të lejohet të gëzojë një nivel të autonomisë sikurse që gëzonte nën Hungarinë, mirëpo jo më shumë. Ky shtet i lirë do të duhej të ishte nën Lidhjen e Kombeve, i përfaqësuar nga Komisioneri dhe në fund të periudhës pesëvjeçare duhet të jetë e lirë të vendoset nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve nëse do të duhej të mbahej referendumi mbi çështjen e sovranitetit definitiv mbi territoret e saj.

IV. I vetmi solucion i pranueshëm, i bazuar mbi parimet e cekura më parë, do të ishte krijimi i Zarës si qytet i lirë me ndërlidhje të lira me shtetin jugosllav. Vetëvendosja duhet gjithsesi të pranohet si bazë e çdo transferi të territorit dhe popullatës.⁵⁵

⁵³ "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 61, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. VII-IX.

⁵⁴ To Robert Lansing, with Enclosure, 25 qershor 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 61, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 170.

⁵⁵ Enclosure, Memorandum whith regard to the Adriatic question, 25 June 1919, Woodrow Wilson, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 61, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey f 170 171

Në mbledhjen e Katërshes së Madhe të mbajtur më 28 qershor 1919, u aprovua edhe një draft të cilit iu bashkëngjijtë edhe një deklaratë e pavarur e presidentit Uilson, e cila i referohet Marrëveshjes së Dodekanezes, duke u përpjekur në këtë mënyrë ta anashkalojë Marrëveshjen e Londrës.⁵⁶ Në draft ritheksohet se, sa i përket Marrëveshjes së Londrës, ajo që nga fillimi nuk u përmbush plotësisht. Italia mori përsipër që ajo t'i angazhojë të gjitha resurset në funksion të luftës së përbashkët me aleatët e saj ndaj armiqve të tyre. Mirëpo, ajo nuk i shpalli luftë Gjermanisë dhe për më se një vit nuk mori pjesë në luftën kundër Turqisë. Sipas Marrëveshjes së Londrës, pjesa qendrore e Shqipërisë do të duhej të formonte një shtet autonom nën protektoratit italian; gjersa Shqipëria Veriore dhe Jugore, nën kushte specifike do t'i kalonin Serbisë dhe Greqisë. Mirëpo, më 1917 Italia proklamoi protektoratin ndaj të gjithë vendit - protektorat që ajo e ka ushtruar që nga atëherë. Sipas Marrëveshjes së Londrës, spikat Uilsoni, Rijeka me aprovimin e Italisë iu akordua Kroacisë. Mirëpo, që nga armëpushimi Italia ka akumuluar trupa në afërsi dhe ligjet lokale kanë hyrë në fuqi në emër të mbretit italian.⁵⁷

Përgjigjja italiane me shkrim, e dorëzuar misionit amerikan në Konferencën e Paqes, ishte e varfër në thelb dhe nuk propozonte ndonjë qasje të re ndaj problemit të Adriatikut. Propozimi i Titonit mbi çështjen e Shqipërisë konsistonte në një ekspansion edhe më të gjerë rreth rajonit të Vlorës, duke përfshirë gati tërë Shqipërinë e Jugut. Kësaj i shtohej edhe mandati italian mbi pjesën e mbetur të Shqipërisë.⁵⁸

Një valë lehtësuese e përfshiu Konferencën në momentin kur u bë e ditur se Asambleja Kombëtare Gjermane në Vajmar, më 23 qershor, dha përgjigje pozitive ndaj ultimatimit të Katërshes së Madhe dhe qeveria e re dha sinjale se do ta nënshkruajë marrëveshjen pa kushte.⁵⁹

Trantativat me palën gjermane korrën sukses dhe me 28 qershor u nënshkrua Marrëveshja e Versajës. Në kundërshtim me paragjykimet e Uilsonit, marrëveshja paqësore që iu servua Gjermanisë ishte larg nga liberalizmi, megjithë respektin ndaj disa çështjeve të tjera. Mori territore thjesht gjermane nga Gjermania, aleatët ishin të determinuar që të krijonin një shtet tampon në Rajnë dhe ta çonin përpara procesin e çarmatimit të

⁵⁶ Meeting of Council of Four, June 28 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 61, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 342.


⁵⁷ Meeting of Council of Four, Appendix – Allies to Italy, June 28 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 61, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 343, 344.

⁵⁸ From Henry White, 19 July 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 61, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 552.

⁵⁹ Po aty.

Gjermanisë, e shtyri atë të nënshkruajë letrën e bardhë për dëmet e luftës, dështoi në adresimin e problemit të bolshevizmit në Rusi,⁶⁰ e gjymtoi atë në aspektin gjeostrategjik, territorial dhe ekonomik, duke i lënë kështu një sërë problemesh në trashëgimi, të cilat do të shërbejnë më vonë si ushqim i pretendimeve ekspansioniste të Gjermanisë.

Uilsoni, të njëjtën ditë, hip në trenin për Brest dhe niset në bordin e anijes Xhorxh Uashington për në SHBA.⁶¹



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Versajes – 28 qershor 1919

Timonin e delegacionit amerikan pas shkuarjes së Uilsonit nga Parisi e mori Frank Llajon Polk, nënsekretar shteti, njohës i mirë i çështjes së Adriatikut. Polk, edhe më herët gjatë punimeve të Konferencës, ishte burim i çmueshëm i këshillave për presidentin Uilson mbi këtë çështje. Në trasimin e qëndrimeve dhe drafteve amerikane mbi problemin e Adriatikut kontribut dhanë, përpos Polkut, edhe ekspertët-zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit: Filips, Xhonson, Kulidxh, si dhe ambasadori amerikan në Paris, Volas.

⁶⁰ Frank Ninkovich "The Wilsonian century – U. S. Foreign Policy since 1900", University of Chicago Press, Chikago & London 1999, f.72.

⁶¹ Po aty.

Muajt korrik deri në shtator e gjejnë Uilsonin të ballafaquar me probleme vendore dhe ndërkombëtare, po aq komplekse dhe urgjente sa edhe vetë problemet që duhej zgjidhur një muaj më parë në Paris. Detyra e tij kryesore ishte sigurimi i përkrahjes nga ana e Senatit për Marrëveshjen e Versajës, në mënyrë që të mund të çohet përpara procesi i ratifikimeve në shqyrtim e sipër. Senatori Loxh me taktika të ndryshme udhëhiqte një politikë të ngadalësimit të shqyrtimit të çështjes në fjalë, në mënyrë që të mblidhte forca dhe të drejtonte kundër Marrëveshjes një fushatë të mirëfilltë.⁶²

Uilsoni fillon një sërë takimesh me republikanët, aleatë potencialë të tij, mirëpo nuk ofron një plan të pranueshëm që do të siguronte fitoren e të dyja palëve në Senat. Më pas, më 19 korrik, Uilsoni pëson një sulm të vogël infarkti, që e çorienton dhe e gjymton atë dhe seriozisht e luhat strategjinë dhe përpjekjet e tij për ratifikimin e paqes dhe të politikës së tij në përgjithësi.⁶³

Uilsoni, si kundërpërgjigje, në shërbim të mbrojtjes së Lidhjes së Kombeve, vendosi që me 25 gusht të ndërmarrë një xhiro fjalimesh njëmujore, në Perendim dhe Mesperëndim, vendim që do të provohet të jetë fatal për shëndetin e tij. Ai për një kohë të gjatë nuk mundi t'u adresohet në mënyrë adekuate problemeve vendore dhe ndërkombëtare për shkak të shëndetit të dobët.⁶⁴

Në ndërkohë, në punimet e Konferencës vërehej interesimi dhe insistimi i italianëve në gjetjen e një zgjidhjeje sa më të shpejtë të çështjes së Adriatikut, meqë Dhoma e Përfaqësuesve do të mblidhej më 28 gusht. Kështu gjenerali Bliss dhe Polku sygjuruan që misioni amerikan të autorizohet t'i dorëzonte Titonit disa propozime si fjala e tyre e fundit mbi projektplanin e Marrëveshjes së Adriatikut. Pranimi amerikan do të kushtëzohej me pranimin e Titonit që propozimet të trajtoheshin si zgjidhje definitive e të gjitha ambicieve italiane në Adriatik.⁶⁵

Për të dalë nga gjendja e vështirë Titoni ndoqi një taktikë të re, atë të „kompromiseve“. Ai e inauguroi këtë në marrëdhëniet me Greqinë, e cila prej kohësh kërkonte të binte në marrëveshje me Italinë për sheshimin e një vargu kontradiktash që kishin midis tyre në Shqipërinë e Jugut, në Azinë e Vogël, në Dodekanez e Trakë. Bisedimet midis Titonit dhe E. Venizellosit përfunduan më 29 korrik me një marrëveshje të fshehtë. Sipas kësaj marrëveshjeje, Italia i bënte Greqisë një varg lëshimesh të cilat kishin të bënin edhe me Shqipërinë. Kështu Roma do të mbështeste në Konferencë kërkesën greke për aneksimin e Korçës dhe të Gjirokastrës, ndërsa Greqia do të përkrahte mandatin italian mbi Shqipërinë e cunuar dhe aneksimin italian të Vlorës. Kjo marrëveshje do

⁶² “The Papers of Woodrow Wilson”, vol. 62, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. VII, VIII.

⁶³ “The Papers of Woodrow Wilson”, vol. 61, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. VII-IX.

⁶⁴ “The Papers of Woodrow Wilson”, vol. 62, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. VII, VIII.

të ishte e vlefshme edhe në qoftë se SHBA do të vazhdonin të kërkonin që Korça të mbetej në kufijtë e Shqipërisë dhe, si pasojë, Greqia do të mund ta merrte vetëm krahinën e Gjirokastrës. Greqia, nga ana tjetër, pranonte t'i lëshonte Italisë për 50 vjet një pjesë të skeles së Sarandës dhe të ruante asnjërinë e kanalit të Korfuzit.⁶⁶

Misioni amerikan në Konferencë, në lidhje me çështjen e Shqipërisë i sugjeron Uilsonit që të japë përgjigje nëse Italisë duhet t'i përkiste mandati ndaj çdo shteti të Shqipërisë, i cili do të mund të krijohet nga Konferenca. Xhonsoni në telegramin e tij të 22 gushtit nënvizonte se protektorati italian ndaj Shqipërisë ishte tej mase i rrezikshëm, meqë Italia dëshiron ta kolonizojë atë dhe në të ardhmen ta përdorë për ekspansion në Ballkan. Në të njëjtën kohë, Xhonsoni mendonte se mandati francez është i pamundur dhe se pranimi i mandatit nga ana e anglezëve është pa ndonjë shans. "Shqiptarët shumë e dëshirojnë mandatin amerikan dhe janë në kundërshtim të theksuar ndaj mandatit italian, mirëpo nëse mandati amerikan është jashtë lojës, thekson Xhonsoni, atëherë i vetmi solucion praktik që mbetet është mandati italian nën mbikëqyrjen sa më të madhe". Po ashtu, përveç opinionit të presidentit mbi këtë çështje kërkohet edhe mendimi i Uilsonit mbi çështjen e kufirit të shtetit të Shqipërisë.⁶⁷

Klemensoa mbronte qëndrimin se çështja e Shqipërisë nuk kishte asnjë arsye që të shtrohej në këtë moment. Me këtë rast, Polk shtroi çështjen para presidentit Uilson për përgjigje, se a duhet ky problem të zgjidhet nga ana e Lidhjes së Kombeve.⁶⁸

Në përgjigjen e Uilsonit mbi projektpropozimin i jepet drita e gjelbër propozimit të delegacionit amerikan në lidhje me pretendimet italiane në Adriatik, në tërësi, sikurse është paraqitur në telegramin e 22 gushtit, përpos renditjes se ardhmëria e Shqipërisë do të duhej t'i lihej Lidhjes së Kombeve.⁶⁹

Negociatat mbi problemin e Adriatikut ishin në vazhden e tyre dhe arritën në një pikë shprese në fund të shtatorit. Misioni amerikan në

⁶⁵ Frank Lyon Polk to Robert Lansing, August 22 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 62, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 456.

⁶⁶ "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Prishtinë, 1969, f.460.

⁶⁷ Frank Lyon Polk to Robert Lansing, August 22 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 62, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 457, telegram i përgaditur nga ana e Xhonsonit dhe Kuligjit.

⁶⁸ Frank Lyon Polk to Robert Lansing, August 22 1919, Polk, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 62, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 457.

⁶⁹ Robert Lansing to Frank Lyon Polk, August 26, 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 62, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 522.

Konferencën e Paqes udhëhiqej nga Polk, Uiliam Filips dhe ekspertët në krye me Xhonson dhe Kulidxh. Nën dritën e zhvillimeve rreth zgjidhjes së njëjës së Adriatikut, qëndrimi i misionit amerikan ishte se çdo koncesion i ndërmarrë nga presidenti amerikan do të ishte i mundur vetëm nëse kjo çështje trajtohet si tërësi dhe nëse ishte në vijën e qëndrimeve të tij të mëparshme.⁷⁰ Sa i përket çështjes së mandatit ndaj Shqipërisë, përfaqësuesit amerikanë mbrojnë qëndrimin se Uilsoni gjithmonë mbronte pikëpamjen se „ky problem nuk duhet të zgjidhet në këtë kohë”. Kundërpërgjigjja e palës italiane ishte se „kjo çështje është me rëndësi për Italinë dhe shpresonte se do të vinte te një zgjidhje e kënaqshme”.⁷¹



Çështja e mandatit të Shqipërisë u diskutua nga ana e përfaqësuesve amerikanë edhe me palën franceze dhe britanike. Pikëpamja unanime e komisionarëve dhe ekspertëve, duke përfshirë edhe Xhonsonin dhe Kulidxhin, ishte se një mandat i vetëm ndaj Shqipërisë së bashkuar është solucioni më i mirë dhe shumë më i mençur sesa çdo solucion që nënkupton ndarjen e këtij vendi ndërmjet Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë, sikurse ishte paraparë në Marrëveshjen e Londrës. Përgjigje të njëjtë morri edhe formimi

⁷⁰ From William Phillips, September 11, 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 63, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 209.

⁷¹ Ibid.

i tri sferave të ndikimit ose tri mandateve të ndryshme përgjatë territorit. Italianët nuk do të pajtoheshin kurrë me mandatin francez, gjersa britanëzët nuk pranonin këtë mandat, theksonte Filips. Po ashtu, edhe mandati amerikan ishte jashtë lojës, kështu që qëndrimi i misionit amerikan ishte se i vetmi solucion praktik do të ishte mandati italian dhe si rrjedhojë e mungesës së zgjidhjes më të mirë, ata nuk duhet t'i kundërviheshin dëshirës së Britanisë së Madhe dhe të Francës për t'i dhënë Italisë një mandat të tillë. Mirëpo, "Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet ta shfrytëzojnë tërë ndikimin e tyre me qëllim që të limitojnë elementet e mandatit, duke penguar kështu kolonizimin, militarizimin dhe eksploatimin e Shqipërisë. Jugosllavisë do t'i garantohej e drejta e konstruktimit, me qëllim të operimit, të hekurudhës në pjesën veriore të vendit, si dhe të rregullojë e të zhvillojë lumin Buna, nëse Mali i Zi do t'i bashkohej shtetit jugosllav". Delegacioni amerikan në letrën dërguar presidentit Uilson dhe Departamentit të Shtetit theksonte se, nëse një pikëpamje e tillë do të aprovohej nga ana e presidentit Uilson, atëherë Klemensoa dhe Llojd Xhorxhi ishin të bindur se do ta shtynin Titonin t'i pranojë modifikimet që kanë të bëjnë me Italinë. Kjo, sipas tyre, do të ishte një pikë në të cilën do të zërthehej shpejt çështja e Adriatikut, e që nuk do të përmbante asgjë që pala jugosllave nuk do ta pranonte. Në fund të letres lutet presidenti Uilson që sa më shpejt që është e mundur, për shkak të fatit të negociatave, ta japë përgjigjen mbi këto çështje.⁷²

Uilsoni e aprovoi projektpropozimin e Filipsit mbi zgjidhjen e çështjes së Adriatikut, përpos disa ndryshimeve të vogla, duke theksuar se e jep dritën e gjelbër për mandatin italian në Shqipëri vetëm nëse restriksionet e theksuara në propozim do të pranoheshin nga ana e Italisë.⁷³

Mirëpo, të gjitha trantativat e mbajtura më parë, si dhe afrimi i zgjidhjes së kontraverzës, u minuan nga pala italiane. Britania e Madhe dhe Franca ndryshuan kursin dhe mbronin tashti pa kushte aspiratat e italianëve, me deklaratat se ishin në favor të dhënies së qytetit të Rijekës Italisë, duke ndryshuar kështu tërësisht kahen e negociatave. Bisedimet ndërmjet Uiliam Filipsit, përfaqësuesit amerikan, dhe Titonit, përfaqësuesit italian, në periudhën në fjalë, sa i përket çështjes së Shqipërisë konsistonin në faktin se, meqë Titoni mendohej t'i ndryshonte elementet e projektmarrëveshjes, Filipsi vendosi që të mos i kumtonte atij përgjigjen e kryetarit ndaj

⁷² From William Phillips, September 11, 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 63, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 209, 210.

⁷³ Joseph Patrick Tumulty to William Phillips, 13 September, 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 63, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 270.

koncesioneve në lidhje me mandatin mbi Shqipërinë, por e futi këtë çështje në paketën e bisedimeve, duke e lidhur pranimin e planit të modifikuar nga ana e delegacionit italian me tejkalimin e kundërshtimit të presidentit Uilson për dhënien e mandatit të Shqipërisë.⁷⁴ Titoni ishte i frustruar dhe kundërshtonte vendosmërisht planin e modifikuar duke insistuar tashti në Rijekën si qytet italian.⁷⁵

Në ndërkohë, më 26 shtator, në momentin kur treni i fushatës së Uilsonit i afrohet Kolorados, ai pëson një infarkt të shkallës së lartë, që pati për rrjedhojë edhe anulimin nga ana e dr. Grejsonit të fushatës së mëtejshme.⁷⁶



Uilsoni kthehet në Uashington më 28 shtator, i sëmurë seriozisht, mirëpo ende në gjendje që të funksionojë në nivel minimal. Mirëpo, më 2

⁷⁴ From William Phillips, 18 September 1919, "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 63, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. 364.

⁷⁵ Fillipsi mendonte se Titoni po bënte vetëvrasje politike, meqë nuk kishte vlerësuar drejtë mbështetjen e Llojd Xhorxhit dhe Klemensoas mbi këtë çështje; si dhe nën dritën e okupimit të Rijekës nga ana e D'anunzio; ibid.

⁷⁶ "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 63, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. VII-XI.

tetor ai përjeton edhe një infarkt i cili ia paralizon pjesën e majtë të trupit. Për disa ditë gjatë tetorit Uilsoni ishte pranë vdekjes. Gjatë kësaj kohe të sëmundjes Uilsoni është i shtrirë në shtrat dhe nuk pranon askënd, përpos Dr. Grejsonit dhe bashkëshortes së tij Edit Uilson, e cila kryen funksionin e mediatorit, duke i bërë të ditur direktivat e shoqit të saj nga dhoma e të sëmurit. Agjencitë e ndryshme qeveritare vazhdojnë të operojnë nëpërmjet krerëve të departamenteve ekzekutive. Disa komunikime të pakta shkëmbehen me Uilsonin e sëmurë. Lansingu e thërret kabinetin në sesion më 3 tetor për shqyrtimin e mundësisë nëse presidenti Uilson ishte i paaftë të ushtronte detyrat presidenciale, në aspektin kushtetues, dhe a do të duhej të thirrej nënpresidenti për marrjen e postit të kryetarit. Lansingu nuk gjen mbështetje për hapa të tillë, mirëpo ai vazhdon ta mbledhë kabinetin për shkëmbime të mendimeve. Në ndërkohë Timulti udhëheq zyrën ekzekutive. Në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilën Uilsoni e mbikëqyrte me xhelozë dhe në mënyrë direkte, tani puna ishte paralizuar. Uilsoni ishte i bindur se Lansingu nuk i ishte besnik në Paris dhe se tentonte të merrte injerencat presidenciale, prandaj refuzon çdo kontakt me sekretarin e tij të shtetit.⁷⁷

Arbër HADRI

ALBANIAN QUESTION AND THE GREAT FOUR IN THE PARIS PEACE
CONFERENCE, JANUARY-NOVEMBER 1919

Summary

The Albanian question in the Paris Peace Conference 1919-1920, was a part of the Adriatic Question and the Greek issue. It was neglected and treated reprehensively and not in accordance with the principles of the Peace frameworks. Furthermore, Albania was treated only as a territory which can be used for different appetites of the bordering countries or dispersal the influence by the Great powers in that part of the Southeastern part of Europe.

The Albanian delegations at the Conference consequently did not have the official treatment and the their influence in the decision making of the bodies of the Conference and the Great Four was frail.

However, embarking the Albanian question on the Adriatic question had a safeguarding outcome since this issue was an nebular issue between the Great Four Powers

⁷⁷ "The Papers of Woodrow Wilson", vol. 63, ed. Arthur S. Link, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, f. VII-XI.

and the emerging countries in the Balkans, so an settlement was not achieved, and in the same manner the Albanian issue was prolonged for a better time.

The role of the President of the USA, Woodrow Wilson on the Adriatic and Albanian issue was great, given that it stood firmly on the fourteen points proclaimed by him for ending the First World War, including the point of the right for self-determination and the unsupported policy for the secret treaties, in this case the London Treaty which wanted to divided Albania between three bordering countries, leaving only a small part of it under a foreign protectorate.

These antagonisms, between the Great Four were increase until the December of 1919, when a provisional settlement was reached.